



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2017-06

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
GJAKOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi, Udhëheqës i Ekipit të Auditimit, dhe Arben Hundozi – Anëtar i ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
5 Qeverisja e mirë.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	32
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	39

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Gjakovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin dhe stafin e Komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e pronës komunale, si dhe pagesat për projektet kapitale në vlerë 85,003€ nuk janë regjistruar në modulën e pasurisë në SIMFK.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunes së Gjakovës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunes se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e pronës komunale siç janë 33 lokale afariste dhe 131 njësi banesore , si dhe pagesat e realizuara përmes procedurave gjyqësore dhe të përmbartimit për projekte kapitale, në vlerë 85,003€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Gjithashtu, zhvlerësimi vjetor për një pjesë të pasurisë jokapitale nuk është llogaritur përmes programit e-pasuria. Kjo reflekton pasaktësi në regjistrat e pasurisë dhe shpalosje jo të saktë të tyre në PVF-të e vitit 2017.

Çështjet kyçe të auditimit

Si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe procedurave të përmbartimit, Ministria e Financave/Thesari, nga buxheti i Komunës së Gjakovës ka certifikuar pagesa në vlerë totale 724,669€ për kryerjen e obligimeve ndaj operatorëve ekonomik. Sipas PVF-ve, në fund të vitit 2017 obligimet e papaguara në total ishin 4,195,629€. Komuna është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente apo kontestive të borxheve, dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 715,000€. Komuna nuk ka parashikuar buxhet shtesë për provizione apo dalje të mundshme të parasë nga proceset gjyqësore. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitet ardhshme.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Gjakovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna e Gjakovës kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Pyetësin e vet-vlerësimit të komponenteve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike; dhe
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe të hyrave me Thesar.

PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Komuna e Gjakovës kishte korrigjuar PFV-të duke përmirësuar raportimin e tyre, megjithatë edhe pas korrigjimit, shpalosja e vlerës së pasurisë nuk është e plotë dhe e saktë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm kemi identifikuar se në Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike, i dorëzuar në KRPP, nuk janë deklaruar gjashtë Aneks Kontrata në vlerë totale 77,804€.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Po ashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike (MAP) të përmirësojnë gabimet të e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të përlllogaritet sipas normave të përcaktuara.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Me tutje, Raporti Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike përpos kontratave të rregullta duhet të përfshijë edhe aneks kontratat e nënshkruara gjatë vitit.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi i projekteve kapitale dhe pagesa e obligimeve vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesa në përfundim të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit për investime kapitale, menaxhimi i personelit, pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	21,229,849	23,473,290	20,942,026	19,437,159	20,104,201
Granti i Qeverisë -Buxheti	17,613,589	17,607,865	16,971,867	16,685,007	17,635,086
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	1,270,435	1,080,250	544,035	348,833
Të hyrat vetjake ³	3,328,760	3,328,760	2,026,574	2,004,529	2,002,422
Financimi nga Huamarrja	287,500	287,500	-	-	-
Donacionet e brendshme	-	101,525	-	30,078	17,218
Donacionet e jashtme	-	877,205	863,335	173,510	100,642

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,243,441€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, por edhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe ndryshimeve të aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, Komuna e Gjakovës ka shpenzuar 89% të buxhetit final ose 20,942,026€, apo 7% më ulët krahasuar me vitin 2016. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	21,229,849	23,473,290	20,942,026	19,437,159	20,104,201
Pagat dhe Mëditjet	13,000,526	13,026,697	12,756,145	12,916,157	12,834,526
Mallrat dhe Shërbimet	1,798,036	1,951,949	1,729,401	1,733,534	1,561,945
Shërbimet komunale	561,899	564,326	529,428	567,520	556,077
Subvencionet dhe Transferet	439,982	464,336	450,163	499,615	660,160
Investimet Kapitale	5,429,406	7,465,982	5,476,889	3,720,333	4,491,493

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Paga dhe Mëditje – buxheti final është rritur për 26,171€ (8,640€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 17,531 nga donacionet);
- Mallra dhe Shërbime – buxheti final është rritur për 153,913€ (156,489€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 3,147€ nga donacionet si dhe zvogëlimi prej 5,732€ sipas vendimit të Qeverisë);
- Shërbimet Komunale – buxheti final është rritur për 2,427€, nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak;
- Subvencionet dhe Transferet – buxheti final është rritur 24,354€ (21,395€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 2,959€ nga donacionet); dhe
- Investimet Kapitale – buxheti final është rritur për 2,036,576€ (1,081,484€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 955,092€ nga donacionet).

Çështja 2 – Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Komuna e Gjakovës nuk ka arritë të realizojë buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve të synuara. Vetëm 73% e buxhetit për investime kapitale ishte realizuar, duke rezultuar me një suficit rreth 2mil.€. Ekzekutimi i ulët lidhur me projektet kapitale është sfida kryesore me të cilën po përballet komuna. Çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit edhe pse ajo është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit. Shkaktarë të ekzekutimit të ulët janë vonesat ne realizim të kontratave, planifikimet e dobëta, vonesat ne fillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimi jo i mirë i kontratave.
- Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2017 ishin në vlerë 2,684,461€. Pjesa më e madhe e tyre, apo 53%, kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna mbledh edhe lloje tjera të hyrave si ato për lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja dhe taksa tjera administrative.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,328,760	3,328,760	2,684,461 ⁴	3,204,552	2,581,209

⁴ Në këtë vlerë nuk janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në trafik dhe dënimet gjyqësore në vlerë totale 346,569€.

Çështja 3 – Verifikimi i pronave të regjistruara

- E gjetura** Komuna ka ndërmarrë veprime në verifikimin e pronave të regjistruara me qëllim azhurnimin e të dhënave ekzistuese për tatimin në pronë, por deri në fund të vitit ka arritë të verifikojë vetëm 24% të pronave të regjistruara. Me UA nr.03/2011 për mbledhjen edhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, kërkohet që brenda vitit të verifikohet 1/3 e pronave të regjistruara.
- Rreziku** Informacioni aktual mund të mos jetë i saktë rreth databazës së tatimit të pronë. Kjo mund të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja 4 – Aplikacionet për leje ndërtimore

- E gjetura** Në auditimin e dy dosjeve për leje ndërtimore kemi identifikuar se aplikacioni për leje ndërtimore, përveç disa informatave bazike, nuk ishte plotësuar me informatat e kërkuara në aplikacion.
- Rreziku** Aplikacionet e pa plotësuara krijojnë paqartësi gjatë shqyrtimit të kërkesës së aplikuesit.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se aplikuesit dorëzojnë dokumentacionin e plotë dhe të saktë në rastin e aplikimit për leje ndërtimore.

Çështja 5 – Vonesa në regjistrimin e të hyrave në SIMFK

- E gjetura** Në pesë raste, të hyrat ishin regjistruar me vonesë në SIMFK. Mangësi janë hasur edhe në menaxhimin dhe sistemimin e dokumentacionit rreth të hyrave në drejtorinë e inspektimit dhe evidencave nga të hyrat e qirasë.
- Rreziku** Vonesat në regjistrim dhe sistemimin e dokumentacionit rreth të hyrave vështirësojnë harmonizimin e të dhënave dhe raportimin financiar.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimin me kohë të të hyrave në SIMFK. Vëmendje ti kushtohet ruajtjes dhe menaxhimit të dokumentacionit.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Në fund të vitit 2017, Komuna e Gjakovës kishte 2,142 të punësuar, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 12,756,145€ apo 98% e buxhetit e kësaj kategorie ekonomike. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 61%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Auditimi ynë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, vlerësimet vjetore të performancës, pensionimet, pushimet pa pagese dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtorit përkatëse, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Çështja 6 – Parregullsi në menaxhimin e personelit

E gjetura

Auditimi në menaxhimin e personelit ka identifikuar se:

- Në procesin e rekrutimit⁵ për dy mësimdhënës/një pozitë të lirë dhe një zëvendësim/, fillimisht ishin përcaktuar të dy kandidatet, mirëpo me pas ishte tërhequr kandidati i cili kishte mbuluar pozitën e lirë. Pas kësaj komisioni kishte rekomanduar që edhe pozita e lirë për mësimdhënës, të mbulohej nga i njëjti kandidat që ishte përzgjedhur për zëvendësim. Si rezultat i kësaj, të dy pozitave, mbahen nga i njëjti mësimdhënës. Gjithashtu, në këtë proces të rekrutimit, përveç raportit përmbledhës, anëtarët e komisionit nuk kishin mbajtur evidencë/raport rreth vlerësimeve individuale për kandidatët e testuar në testin me shkrim dhe intervistë;
- Në konkursin për pozitën *mjek i përgjithshëm*, testi me shkrim i të punësuarit nuk ishte i nënshkruar;
- Në 33 raste pozitave mbulohehin me ushtrues pozite (UD) përtej afatit kohor të lejuar. Në QKMF, 29 pozita ishin mbajtur nga data 30.09.2016 deri në fund të vitit. Në tri shkolla, pozita e drejtorit ishte mbajtur me UD përtej afatit ligjor prej tre muajve. Ndërsa, pozita *Shef i zyrës ligjore*, mbahej me UD nga data 01.08.2016;

⁵ Procesi i rekrutimit është organizuar dhe udhëhequr nga Drejtoria Komonale e Arsimit.

- Në një rast, përvoja e punës së të punësuarës ishte kalkuluar për dy vite më shumë se sa ishin dëshmitë e ofruara. Nuk kishte as vendim nga zyra e personelit që përcakton numrin e viteve të përvojës së punës për punonjësen;
- Për një mësimdhënëse, vendimi për pushim lehonie ishte bërë një muaj pas fillimit të pushimit. Edhe ndalesa në pagë ishin bërë me një muaj vonesë. Në rastin tjetër, vendimi për pushim të lehonisë ishte bërë një javë pas fillimit të pushimit; dhe
- Kontratat e punës për mësimdhënës, nuk ishin përpiluar sipas formatit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kjo ngase te pjesa e pagës nuk ishte përcaktuar edhe përvoja e punës.

Rreziku Mangësitë e hasura në menaxhimin e personelit, përfshirë procesin e rekrutimit, pagesën e pagave dhe përpilimit të kontratave mund të rezultojnë në mos përmbushjen e duhur të detyrave por edhe me gabime potenciale në shpenzimet për pagat e punonjësve. Gjithashtu, mbajtja e pozitës udhëheqëse me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj nuk siguron që punët realizohen me përgjegjësi të plotë dhe që arrihen rezultatet e pritura.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit dhe pagesave bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante. Në këtë aspekt duhet të forcohen kontrollet në proceset e rekrutimit në mënyrë që komisionet të bëjnë vlerësim objektiv në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Gjithashtu kryetari duhet të ndërmarrë veprime shtesë për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me UD. Kohëzgjatja e funksionit si UD nuk duhet të jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra e shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 2,516,274€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,258,829€, apo 90% e buxhetit. Kryesisht ato kanë të bëjnë me shpenzimet e shërbimeve komunale dhe me aktivitetet operative që ndërlidhen me shpenzimet për udhëtime zyrtare, shërbime tjera kontraktuese, furnizim për zyre dhe pajisje, mirëmbajtja e ndërtesave etj.

Çështja 7 - Kontrollë jo efikase në procesin e certifikimit të pagesave

- E gjetura** Si rezultat i kontrolleve jo efikase, janë certifikuar për pagesë këto lëndë në mungesë të dëshmive, si:
- Lëndës për shpenzimet e derivateve në vlerë 113€ i mungonin informatat rreth kalkulimit të çmimit mujor të derivateve sipas bursës. Mungonte edhe autorizimi për shfrytëzimin e veturës private; dhe
 - Për shpenzimet e reprezentacionit, Komuna nuk kishte kontratë për furnizim me operatorin ekonomik nga i cili ishin furnizuar.
- Rreziku** Lëndët e pa kompletuara mund të rezultojnë me pagesa të parregullta të cilat në raste të caktuara mund ta dëmtojnë buxhetin e komunës.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave. Certifikimi i pagesave duhet të bëhet vetëm pasi lëndët të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm.

Çështja 8 - Parregullsi në aktivitetin e prokurimit

- E gjetura** Komuna nuk ka arritur të zbatojë udhëzimet e prokurimit për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Kjo ka rezultuar në
- Te kontrata për Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës në vlerë 109,900€, ishte kërkuar që objekti i Bibliotekës të sigurohet nga dy punonjës, 24 orë në shtatë ditë të javës. Angazhimi i vetëm dy punëtorëve për orarin e përcaktuar bie ndesh me ligjin e punës, përkitazi me orarin e punës dhe pushimin e nevojshëm për të punësuarit; dhe
 - Te kontrata Furnizim me produkte ushqimore, higjienike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës - Pjesa e III-të në vlerë 32,226€, siguria e ekzekutimit nuk mbulonte periudhën prej 30 ditëve pas kompletimit të kontratës, ndërsa te kontrata Sigurimi fizik i objekteve të Komunës në vlerë 109,900€, sigurimi i ekzekutimit ishte valid deri më datë 18.08.2018, ndërsa kontrata përfundonte me 01.09.2018. Përveç që nuk e mbulonte në tërësi afatin e kontratës, sigurimi nuk mbulonte as periudhën prej 30 ditëve nga përfundimi i kontratës.
- Rreziku** Mos zbatimi i kornizës ligjore të prokurimit publik dhe anashkalimi i tyre gjatë lidhjes së kontratave rrit rrezikun që kontratat mund të mos realizohen sipas kushteve kontraktuale.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e masave/procese të duhura për të siguruar se kërkesat ligjore të prokurimit publik zbatohen në tërësi. Kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit të jenë matshme dhe të arritshme për kontraktuesit.

Çështja 9 – Kontrata për shërbime të veçanta përtej afatit ligjor.

E gjetura Komuna kishte angazhuar punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, dhe në shtatë raste kontratat e tyre kishin zgjatur përtej afatit ligjor prej gjashtë muajve.

Rreziku Në mungesë të monitorimit të mjaftueshëm ekziston rreziku që shërbimet mos të përfundohen në përputhje me kushtet e kontraktuara. Vazhdimi i kontratave përtej afatit ligjor bie ndesh me rregullat ligjore.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes marrëveshjet për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 464,336€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 450,163€ apo 97% e buxhetit. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare në fushën e ekonomisë, sportit, bujqësisë dhe shëndetësisë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,465,982€, ndërsa janë shpenzuar 5,476,889€, ose 73% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturën rrugore, në renovimin e objekteve arsimore, në fushën e shëndetësisë etj.

Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e projekteve kapitale.

E gjetura Mangësitë e hasura në auditimin e mostrave në fushën e investime kapitale janë:

- Gjashtë kontrata për projekte kapitale në vlerë totale 1,324,912€, të nënshkruara në vitin 2012 dhe 2013, nuk ishin përfunduar as në vitin 2017. Planet dinamike të realizimit të këtyre projekteve ishin nga 28 deri në 120 ditë kalendarike. Kontratat ishin nënshkruar në mungesë të buxhetit të nevojshëm;
- Nga mostrat e testuara, është identifikuar se si pasojë e mos pagesës me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, përmes procedurave përbarimore, gjykatave dhe nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 82,596€. Në mungesë të buxhetit në kategorinë përkatëse, ishin shfrytëzuar mjetet nga kategoritë tjera buxhetore;
- Komuna ka të kontraktuar një kompani për mbikëqyrjen e projekteve kapitale. Përveç situacioneve teknike të punimeve, në raportet e përgatitura nga kompania nuk janë ofruar informata të mjaftueshme rreth ecurisë së realizimit të projekteve kapitale; dhe
- Për tri kontrata, Plani i Menaxhimit të Kontratës (PMK) ishte përgatitur dhe nënshkruar me vonesë, ndërsa në tri raste tjera PMK-të nuk ishin azhurnuar me informata të duhura.

Rreziku Dobësitë aktuale mund të ndikojnë në vlerë të dobët për para, pagesa të parregullta, kosto shtesë si pasojë e padive nga mos pagesa me kohë e obligimeve si dhe vonesa në ofrimin e shërbimeve që mund të rezultojnë në kontrata të cilat nuk zbatohen sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të sigurohet buxheti i duhur për realizimin e tyre. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë rregullisht zbatimin e projekteve, dhe të hartojnë raporte në të cilat ofrohen informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit. Për çdo vonesë të paarsyetuar në realizimin e projekteve të aplikohen penalet.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta në fushën e prokurimit që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 – Planifikimi dhe blerjet përmes procedurave të prokurimit

E gjetura Zbatimi i pritur i udhëzimeve të prokurimit nuk është arritur për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Kjo ka rezultuar në:

- Ngecje në realizimin e planit të prokurimit. Kjo ka rezultuar si pasojë e mos inicimit me kohë të kërkesave për blerje nga njësit kërkuese, por edhe vlerësime të pasakta të vlerave të parashikuara të furnizimeve. Dy aktivitete të prokurimit kishin filluar me dy muaj vonesë nga data e aprovimit për inicimin e procedurave të prokurimit;
- Nënshkrim i kontratave pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve. Kontrata për *Mirëmbajtjen verore të rrugëve*, në vlerë 159,561€ ishte nënshkruar me vetëm 1,000€ zotim të mjeteve, përderisa pas 10 ditëve Komuna kishte pranuar faturën/obligimet për shërbimet e kryera në vlerë 4,610€. Kontrata *Ndërtimi i terreneve sportive në disa shkolla* në vlerë 44,459€, ishte nënshkruar me vetëm 9,790€ zotim të mjeteve. Po ashtu kontrata *Ndërrimi i dyerave dhe dritareve në disa shkolla* në vlerë 20,140€ ishte nënshkruar me vetëm 10,000€ zotim të mjeteve.
- Kontrata në vlerë përtej vlerës së parashikuar. Komuna ka lidhur tri kontrata përtej vlerës së parashikuar me planin e prokurimit. Bëhet fjalë për kontratat, si:
 - a. *Mirëmbajtja verore e rrugëve*, në vlerë 159,561€, ndërsa me planin e prokurimit kontrata ishte vlerësuar të jetë vetëm 100,000€;
 - b. *Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i QKMF, QMF, AMF, QPS*, në vlerë 71,111€, ndërsa me planin e prokurimit kontrata ishte vlerësuar 61,800€; dhe
 - c. *Furnizim me material dhe reagensa për laboratorin biokimik-hematologjik* në vlerë 22,228€, me planin e prokurimit ishte vlerësuar 15,000€, ndërsa me Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve ishin planifikuar vetëm 17,458€.

- Zotimi i mjeteve dhe përgatitja e urdhërblerjes me vonesë. Si rezultat i mos zotimit të buxhetit me kohë dhe në vlerë të mjaftueshme, për pesë fatura në vlerë totale 363,683€ ishin paguar vetëm 129,958€. Në një rast tjetër, një pjesë e faturës (891€) ishte paguar nga buxheti i një projekti tjetër.

Rreziku Dobësitë e hasura në planifikim, inicim dhe realizim të aktiviteteve të prokurimit mund të ndikojnë negativisht në aspektin buxhetor dhe në zbatim të kontratave.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Në këtë aspekt, të bëhen analiza të detajuara lidhur me planifikimin e projekteve për të tejkaluar sfidat e identifikuar lidhur me afatet kohore për fillimin e procedurave dhe fondet e planifikuara për realizimin e tyre. Me tutje, të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 12 - Klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve

E gjetura Në tri kontrata të testuara në vlerë 90,049€ kemi identifikuar keq-klasifikim të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike, si:

- Mjetet e zotuar për kontratën Mirëmbajtja verore e rrugëve në vlerë 1,000€ ishte klasifikuar si shërbime kontraktuese tjera;
- Shpenzimet për kontratën Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i QKMF, QMF, AMF, QPS në vlerë 3,500€ nuk ishin klasifikuar si mirëmbajtje e objekteve shëndetësore, por vetëm si mirëmbajtje e ndërtesave; dhe
- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe furnizim me material për ndriçim publik, në vlerë 85,459€ ishin planifikuar dhe klasifikuar si investime kapitale ndërsa marrë parasysh natyrën e shpenzimit dhe vlerën e furnizimeve, shihet se i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në kode jo adekuate shkakton paqartësi në raportimin e shpenzimeve të ndodhura. Kjo rezulton në mbivlerësimin e shpenzimeve në një kod ekonomik, kundrejt nënvlerësimit në kodin tjetër.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe regjistrohen në kode përkatëse ekonomike.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna e Gjakovës ka bërë vlerësimin dhe njehsimin fizik të pasurisë në fund të vitit. Sipas PVF-ve, vlera neto e pasurisë kapitale në fund të vitit është 52,580,262€, ndërsa e pasurisë jokapitale 395,783€. Gjatë vitit 2017, një komision punues ishte krijuar në identifikimin dhe vlerësimin e pronës publike. Një pjese e pronave ishin vlerësuar nga komisioni dhe ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së.

Çështja 13 - Regjistër jo i plotë i pasurisë

E gjetura Me gjithë angazhimet Komuna e Gjakovës ende nuk ka arritë të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurisë së përgjithshme. Ndonëse të gjitha pagesat e çertifikuara për investime kapitale nga Komuna ishin regjistruar në modulën e pasurisë në SIMFK, pagesat e çertifikuara nga Thesari kishin mbetur të paregjistruara.

Rreziku Mungesa e një regjistri të përgjithshëm të pasurisë, vështirëson menaxhimin e duhur të pasurisë, dhe se nuk përmbushë kërkesat ligjore për raportim të drejtë financiar.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat ligjore për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë janë përmbushur. Komisioni punues të vazhdojë punën në identifikimin dhe vlerësimin e tërë pasurisë në pronësi të komunës, si dhe të gjitha pasuritë kapitale të evidentohen në regjistrin kontabël të thesarit.

Çështja 14 - Mungesë e kontrolleve në menaxhimin e automjeteve zyrtare

E gjetura Ekzistojnë dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare. Komuna nuk ka zyrtar të caktuar që menaxhon me veturat zyrtare. Secila drejtori menaxhon në mënyrë individuale me automjetet. Nuk ka evidencë të plotë e të saktë rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare. Nga mostra e testuar kemi gjetur se mungojnë kërkesat e veçanta dhe aprovimet për përdorimin e tyre, shënime rreth kilometrave të kaluara, servisimit, qëllimit të përdorimit, etj.

Rreziku Mungesa e kontrolleve dhe menaxhimit rrit rrezikun që automjetet mund të shfrytëzohen edhe për qëllime tjera jo zyrtare.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen në pajtim me rregullat dhe kërkesat ligjore. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë lidhur me kilometrat e kaluara, serviset e bëra si dhe të dhëna tjera të nevojshme.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (Ll/A) kanë të bëjnë me tatimin në pronë, taksa në biznes dhe të hyrat nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale.

Çështja 15 - Menaxhimi jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Ll/A nuk janë menaxhuar si duhet. Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në inkasimin me kohë të të hyrave. Siç edhe është prezantuar në PVF, vlera e përgjithshme e tyre arrinë në 8,505,710€, ku 87% e tyre i takon tatimit në pronë.
- Rreziku** Vonesat në inkasimin e të hyrave reduktojnë fondet e mbledhura për buxhetin e Komunës.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar inkasimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.

3.11 Obligimet e papaguara

Sipas PFV-ve, obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,340,211€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasura. Komuna ka shpalosur edhe obligime lidhur me vendimet për shpronësime në vlerë 1,820,011€, si dhe situacionet e punimeve të kryera deri në fund të vitit 2017 në vlerë 1,035,407€. Gjithashtu, Komuna e Gjakovës përballet edhe me detyrime kontingjente, dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 715,000€.

Çështja 16 - Menaxhim i dobët i obligimeve

- E gjetura** Komuna nuk ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Ashtu siç edhe është prezantuar në pasqyrat vjetore financiare, obligimet e papaguara datojnë që nga viti 2011 e tutje. Pjesa më e madhe e obligimeve u takon investimeve kapitale. Obligimet nuk janë paguar për shkak të hyrjes në to, pa u siguruar mjetet buxhetore. Si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve ndaj furnitorëve, përmes procedurave gjyqësore dhe nga Thesari, nga buxheti i Komunës janë kryer pagesa në vlerë 724,669€. Po ashtu, kemi vërejtur vonesa në pagesë, mos pagesë e plotë e obligimit të faturuar si dhe raste të mos protokollimit të faturave me rastin e pranimit.
- Rreziku** Hyrja në obligime pa u siguruar paraprakisht mjetet financiare si dhe mos pagesa me kohë e obligimeve mund të shkaktojë kosto shtesë dhe dëmtim të buxhetit nga ngritja e padive gjyqësore prej furnitorëve. Mos mbajtja e një libri

të protokollit për faturat e pranuar, mund të rezultojë me vonesa të pagesave të faturave apo edhe me pagesa të dyfishta.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar, ndërsa me pas duhet të sigurohet se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e tyre.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Gjakovës ka rezultuar në 22 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, por që ky plan nuk është dorëzuar me kohë në ZKA. Plani është mbështetur me një proces konfirmues dhe se zbatimi i rekomandimeve është monitoruar formalisht nga menaxhmenti.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, shtatë rekomandime janë zbatuar; 11 ishin në proces të zbatimit dhe katër nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 13 rekomandime, dhe në vitin 2017, pesë nga to ishin zbatuar, shtatë rekomandime tjera ishin në zbatim e sipër dhe një nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 17 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm.

E gjetura Komuna e Gjakovës nuk ka zbatuar kërkesat për të hartuar dhe dorëzuar në ZKA një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016. Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është dorëzuar me tre muaj vonesë. Përderisa vetëm pjesërisht janë zbatuar disa nga rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara sa duhet. Ne nuk kemi vërejtur se menaxhmenti aplikon masa përgjegjësie për mos zbatimin e rekomandimeve.

E gjetura Përmirësimet e kërkuara të proceseve operationale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm dhe humbje financiare.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston ende një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Gjakovës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura sa duhet. Komiteti i auditimit është themeluar vonë, ndërsa Auditimi i Brendshëm nuk ka arritë të ofrojë siguri të mjaftueshme dhe pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës por edhe planet vjetore, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna e Gjakovës ka hartuar Strategjinë zhvillimore socio-ekonomike lokale 2016-2018. Drejtoritë komunale kishin hartuar raportet vjetore të punës, por jo edhe planet vjetore, me përjashtim të tri⁶ drejtorive.

⁶ Drejtoria për mbrojtje e shpëtim, drejtoria për zhvillim ekonomik, dhe drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 18 – NjAB dhe plani i auditimit të brendshëm

E gjetura Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:

- NjAB nuk është plotësuar me personel të mjaftueshëm. Komuna ka vetëm një auditor të brendshëm. Sipas UA 23/2009, kërkohet që subjekti që ka mbi 5mil€ buxhet vjetor duhet të ketë se paku tre auditor të brendshëm. Komuna e Gjakovës ka buxhet mbi 23mil€;
- Plani vjetor i auditimit të brendshëm nuk është bazuar në fushat më me rrezik. Projektet kapitale, menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i personelit, obligimet dhe llogaritë e arkëtueshme nuk janë përfshirë në planin e auditimit, ndërsa prokurimi publik dhe të hyrat vetanake ishin përfshirë, mirëpo nuk janë trajtuar mjaftueshëm në raportet e auditimit të brendshëm.
- Fokus i auditimit të brendshëm ishin aktivitetet e vitit 2016 dhe vetëm fillimi i vitit 2017;
- Plani vjetor i auditimit nuk ishte realizuar sipas afateve të planifikuara;
- Nuk janë përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së; dhe
- Komiteti i Auditimit (KA) nuk është themeluar në vitin 2017. Menaxhmenti ka arritë që në mars të vitit 2018 të krijojë këtë komitet.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Kjo, gjithashtu, tregon cilësi të dobët të planifikimit të auditimit të brendshëm.

Rreziku Një program jo i plotë i auditimit i cili nuk pasqyron rreziqet e hasura nga organizata, ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrole duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare për Komunën. Kjo mund të rezultojë me dobësi tjera të paidentifikuara, mos reagim me kohë ndaj sfidave potenciale dhe vazhdim të praktikave joefektive që mund të përfundojnë me vlerë të ulët për para dhe/apo humbje potenciale financiare për komunën.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të punojë me drejtorin e NjAB-së për të siguruar aktivitete të mjaftueshme mbi sistemet financiare të periudhave aktuale me fokus në fushat me rrezik më të lartë. Përmbushja e planit vjetor të NjAB-së duhet të monitorohet rregullisht nga menaxhmenti në mënyrë që devijimet të adresohen në kohën e duhur. Përveç plotësimit të NjAB-së me staf të mjaftueshëm, Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të KA-së.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 19 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale nuk është shpenzuar. Planifikimi i dobët i nevojave, vonesat në procedurat e prokurimit, mbikëqyrja e pamjaftueshme, dhe obligimet e papaguara, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Disa prej projekteve as që kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata ishin subjekt i shqyrtimeve gjyqësore dhe procedurave përmbartimore.

Në fillim të vitit 2018 ka filluar me procesin e menaxhimit të rrezikut. Gjatë vitit 2017 Komuna nuk kishte politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Ende nuk ekziston ndonjë regjistër formal i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe nuk përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre. Gjithashtu shumica e drejtorive komunale nuk kishin përgatitur as plane vjetore të punës për vitin 2017.

Rreziku Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies, planifikimit dhe menaxhimit reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar dhe operativ. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të siguroj se ecuritë buxhetore, përfshirë planin e prokurimit dhe shpenzimet do të jenë subjekt i analizave dhe rishikimeve të rregullta nga ana e komunës. Për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetarja duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Sa i përket palëve të treta, për vitin 2016 duhet të kompletohen saktë.	Po		
2.3 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore	Kryetarja duhet të siguroj se krijohet një strategji e përgjithshme për trajtimin e borxheve të mbetura, përfshirë buxhetimin e tyre. Rastet ku komuna konteston rregullsinë e pagesave nga përmbaruesit privat, të procedoj në instanca më të larta shqyrtimin e lëndëve.			Nuk janë marrë masa.
3. Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetarja duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar për monitorim rigoroz të këtij procesi.		Në proces të zbatimit. KGJ ka filluar me procesin e menaxhimit të rrezikut, ka themeluar KA, dhe se janë shtuar kontrollet ne procesin e prokurimit. Është përmirësuar menaxhimi i të hyrave, ka filluar protokolimi i faturave dhe se një pjesë e pasurisë kapitale janë regjistruar në SIMFK.	

2.5 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetarja duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe në mënyrë pro aktive të bëhet adresimi i fushave me dobësi të identifikuar. Duhet të aplikohet një mekanizëm rishikues për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për përgjigjet e konfirmuara.	Po		
2.6 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetarja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.		Në proces të zbatimit. Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime dhe ka filluar me procesin e menaxhimit të rrezikut.	
2.7 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetarja duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm bëhet funksional dhe përfitimet maksimale merren nga shërbimet e sigurisë të ofruara nga AB. Më tej, të sigurohet se përbërja e kapaciteteve njerëzore si në njësinë e auditimit, ashtu edhe në Komitetin e Auditimit, është në përputhje me rregullat për funksionimin e sistemit të AB.		Në proces të zbatimit. Ndonëse në fillim të vitit 2018, është themeluar Komiteti i Auditimit, mangësit janë evidente edhe më tutje në auditimin e brendshëm.	
3.4 Prokurimi	Kryetarja duhet të kërkojë përgjegjësi nga personat që kanë lejuar lëshimet dhe humbjet e mësipërme financiare. Zyra e prokurimit duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve, dhe gabimet e tilla të mos përsëriten. Një planifikim i hollësishëm është i nevojshëm dhe njësitë duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.		Në proces të zbatimit. Janë shtuar kontrollet në proceset e prokurimit, por mangësi janë hasur në planifikimet e prokurimit.	

3.4 Prokurimi	Kryetarja të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e rregulloreve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Në rastin e trajnimit të stafit shëndetësor në të ardhmen, Kryetarja të shqyrtojë mundësitë e trajnimit nga vet pjesa e stafit. Punimet të mbikëqyren në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi merret siguri se pozicionet janë realizuar si dhe mangësitë e tjera në procesin e prokurimi të mos përsëriten.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Komuna duhet të ndalojë fenomenin e pagesës së shpenzimeve operative të përfituesve të ndryshëm, derisa lënda për pagesë të ketë dokumentacionin relevant. Rasti i ngrohtores të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Më tej, procedurat e prokurimit të mos anashkalohen në asnjë rast ku ato mund të jenë të zbatueshme.	Po		
3.6 Të hyrat	Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, burime të mjaftueshme të vihen në dispozicion për verifikimin e pronave të tatimpaguesve.		Në proces të zbatimit. Komuna ka filluar me procesin e verifikimit, por nuk ka arritë të verifikojë 1/3 e pronave të regjistruara.	

3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetarja duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdojë dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e mallrave/pasurive të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive.		Në proces të zbatimit. Komuna e Gjakovës ka arritur që një 21 lokale afariste të vlerësojë dhe regjistrojë në SIMFK, ndërsa një pjesë tjetër të pronës ende nuk ka arritur ta evidentojë në regjistër.	
3.7.2 Trajtimi i të arketueshmeve	Kryetarja të sigurojë se drejtoria për zhvillim ekonomik mbikëqyrë mjaftueshëm historikun e taksave në biznes. Shpalosjet në pasqyra, vitin e ardhshëm ti nënshtrohen një kontrolli detal dhe të vihen kontrolle të dukshme në mbarëvajtjen e qiradhënieve. Çdo qiradhënie të mbështetet me bazë të fortë kontraktuale dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi.	Po		
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetarja duhet të instalojë sistem të protokollimit të çdo fature të pranuar nga komuna. Po ashtu, të sigurojë se konfirmime formale për faturat e papaguara bëhen nga departamentet përgjegjëse ndaj kërkesave të ZKF-së.		Në proces të zbatimit. Komuna ka filluar me procesin e protokollimit me rastin e pranimin të faturave, por jo në të gjitha rastet është bërë protokollimi i tyre.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. 3 Pasqyrat Vjetore Financiare	Të bëhet një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e Theksimit të Çështjes së Opinionit. Të adresohen shkaqet e gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale, si dhe të sigurohet regjistër i plotë dhe i saktë të pasurive komunale.		Në proces të zbatimit. Me gjithë mangësit. Komuna ka arritur që një pjesë e pronave të regjistrojë në SIMFK.	
	Të sigurohet që procesi i përgatitjes së PFV-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar në PFV.		Në proces të zbatimit. Mangësi janë hasur në shënimet shpjeguese.	

2.1 Zbatimi i rekomandimeve	Komuna të hartoj plan veprimi i cili do të jetë i zbatueshëm sipas afateve të përcaktuara.		Në proces të zbatimit. Komuna ka hartuar Planin e veprimit por nuk ka arritë të zbatojë në tërësi rekomandimet e dhëna.	
2.2 Vet-vlerësimi	Vet-vlerësimi i proceseve bëhet me një shkallë të lartë objektiviteti dhe se vlefshmërinë e pohimeve të vetëvlerësimit, përveç konfirmimeve të menaxhmentit, e bën edhe auditimi i brendshëm.	Po		
2.3.2 Raportimi menaxherial	Të bëhet një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë.		Në proces të zbatimit. Është përmirësuar formati dhe cilësia e raportimit.	
2.4 Auditimi i Brendshëm	NjAB të plotësohet me personel të mjaftueshëm, dhe aktivitetet e ardhshme të NjAB duhet të fokusohen drejt zhvillimit dhe zbatimit të planeve të auditimit dhe strategjinë e auditimit të bazuar në rrezik. Të formohet Komiteti i Auditimit.		Në proces të zbatimit. Ndonëse KGJ ka themeluar KA, NjAB-në nuk ka arritë ta plotësojë me personel shtesë. Edhe plani vjetornuk është bazuar në rrezik.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Performanca buxhetore të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat.		Në proces të zbatimit. Përveç buxhetit për investime kapitale, buxheti i kategorive tkera ekonomike është realizuar në nivel të mirë.	
3.1.1 Të hyrat	Të bëhen harmonizimeve të rregullta mujore ndërmjet drejtorive komunale dhe administratës së financave si dhe të vendos kontrole të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake të komunës. Të bëhet edhe procesi i verifikimit të pronave komunale.		Në proces të zbatimit. Janë bërë harmonizime të rregullta, por mangësi janë evidentuar në verifikimin e pronave.	
	Departamenti i urbanizmit të shqyrtoj të gjitha kërkesat e qytetarëve brenda afateve ligjore.	Po		

3.1.2 Pagat dhe Mëditjet	Kompensimi i zyrtarëve për punë jashtë orarit të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të sigurohet se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda një periudhe të specifikuar kohore.	Po		
3.1.3 Mallrat e Shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Të ndalet në burim dhe të paguhet tatimi dhe kontributet pensionale për personat e angazhuar për shërbime të veçanta.	Po		
	Pagesë të bëhet vetëm pasi të jetë kryer shërbimi dhe të mos pranohen faturat dhe raportet pa pranim të shërbimeve.	Po		
3.1.4 Subvencione dhe Transfere	Subvencionet shpenzohen sipas qëllimit të dedikuar. Drejtoritë përkatëse mbikëqyrin dhe raportojnë në formë të detajuar, dhe pagesat përcillen me dëshmi të mjaftueshme.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Projektet duhet të realizohen konform planeve dhe buxhetit. Kur shfaqet nevoja për ridestitim të mjeteve apo ndryshim të projekteve, kjo të reflektohet në planet e rishikuara të buxhetit.			Nuk janë marrë masa.
	Projektet të realizohen në pajtim me planifikimet paraprake.			Nuk janë marrë masa.
	Njësitë kërkuese të vlerësojnë dhe të planifikojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim, si dhe të respektohen në plotësi LPP si dhe UA përkatës.			Nuk janë marrë masa.
	Të forcohen masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave. Pagesat të bëhen vetëm pasi të merret siguria e plotë se pozicionet e kontraktuara janë realizuar sipas paramasave dhe parallogarisë.	Po		

	Njësitë kërkuese vlerësojnë drejtë kërkesat për prokurim. Zyra e prokurimit duhet të mbikëqyrë komisionet vlerësuese dhe të shtoj kujdesin me rastin e përlllogaritjes së pozicioneve, si dhe gabimet të vërehen me kohë dhe të korrigjohen.		Në proces të zbatimit. Nuk ka gabime në përlllogaritjen e pozicioneve, por dobësi janë hasur në vlerësimin e nevojave vjetore.	
	Pagesat e shpenzimeve të bëhen në kode adekuate.		Në proces të zbatimit. Në përgjithësi shpenzimet janë regjistruar drejtë, me përjashtim të tre rasteve të keqklasifikimit.	
3.2 Pasuritë	Të krijohet një regjistër i plotë dhe i saktë i pasurisë. Të aplikohet e-pasuria.		Në proces të zbatimit. Perderisa ka përmirësime në vlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë, angësi janë hasur në zhvlerësimin e pasurisë jokapitale.	
3.2.2 Të arkëtueshmet	Të vendosen kontrolle më efektive, ashtu që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.		Në proces të zbatimit. Me gjithë përmirësimet, KGJ nuk ka arritë të inkasojë me kohë të hyrat e faturuara.	
3.3 Obligimet e papaguara	Të shqyrtohen në mënyrë kritike gjendja e detyrimeve të papaguara. Pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF apo edhe sipas vendimeve gjyqësore.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Dakovica-Municipality of Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO				
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE				
Data e dorëzimit:		10.05.2018		
No. Dok. / No. Dok.	Çmimi / Vlerë / Price / Cost	Rr. Post. / Post No.	No. Fajdeve / No. Pages	
04	400	611	1	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ardian Gjini

Kryetar i Komunës,

Data: 08/05/2018, Gjakovë,

